

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN Departamenti i Përgjithshëm** përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Ramiz Azizi me zyrtaren ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit L. R. nga Gj,për shkak të veprës penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 345 paragrafi 1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1955/16 e datës 28.10.2016, të cilën e përfaqësonte prokurorja e shtetit Leonora Shemsiu-Kadri, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor e publik më datën 18.04.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë :

### A K T G J Y K I M

I akuzuari L. R. nga i ati Sh.dhe nëna H., e lindur Sh, i lindur me datë ..në V tani me vendbanim në Gj në rrugën “,i martuar baba I dy fëmijeve,ka të kryer shkollën e mesme, me profesion argjendtar,I gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### Është fajtor Sepse

-Më datën 19.10.2016, në lokalin e tij në n, te kompleksi i artarive, saktësisht te artaria “S”, me qëllim vjedhje e shitje, ka blerë nga i mituri nga fshati K k.e Kamenicës, një sasi ari, dhe atë një hallkë të dorës dhe një unazë dhe për këtë sasi ari, i pandehuri i ka paguar të miturit qmimin prej ... Eurove, të cilën sasi të arit, i mjituri e kishte vjedhur në shtëpinë e tij aty ku jeton, edhe pse i pandehuri e ka ditur, dhe ka mundur ta dijë se sasia e arit ka mundur me qenë e përfituar me kryerjen e veprës penale të vjedhjes.

Me çka ka kryer veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 345 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,23,49,50,51,52 e 73 të KPRK-ës si dhe të neneve 365 e 451 të KPPRK-ës, të akuzuarit i shqipton.

### DËNIM ME KUSHT

Kështu që të akuzuarit ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **90 (nëntëdhjetë) ditëve**, të cilin dënim nuk do ta vuaj nëse në afatin prej **1 (një) viti**, nga

dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, e në të kundërtën ai do të revokohet.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shumë prej 20 (njëzet) Euro, në emër të paushallit gjyqësor si dhe në emër të harxhimeve të procedurës penale në shumë e përlllogaritur në llogarinë përfundimtare të kësaj gjykate, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan e ka ngritur aktakuzën e saj PP.II.1955/16 të datës 28.10.2016 kundër të akuzuarit nga Gj për shkak të veprës penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 345 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Në shqyrtimin fillestar të datës 18.04.2017 Prokurorja e Shtetit Leonora Shemsiu-Kadriunë fjalën e sajë përfundimtare, pohoi se pasi që i akuzuari e pranoi fajësinë, kërkoj që i njëjti të shpallet fajtor për veprën e cila i vihet në barrë në aktakuzë, atij ti shqiptohet dënimi meritor i paraparë me ligj.

E dëmtuara, në fjalën e saj përfundimtare, pohoi se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale, pasi që malli i është kthyer asaj si dhe nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike.

Në fillim të shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari pohoi se e kam kuptuar aktakuzën në tërësi si dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar se e pranoj në tërësi dhe vullnetarisht fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e cila sipas kësaj aktakuze më vihet në barrë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të prokurorit dhe të akuzuarit konstatoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 paragrafi 1 të KPPRK-së, për pranimin e fajësisë, ngase i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza me materialet që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike:

Se i akuzuari nga Gj, me qëllim e kryer veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 345 paragrafi 1 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin për shkak të kryerjes së vepres penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 345 paragrafi 1 të KPRK-ës, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit të lartcekur gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 73 të KPRK-së, ku si rrethanë lehtësuese gjykata gjeti se ai e ka pranuar vullnetarisht fajësinë, se atë e ka kryer nga pakujdesia, se më parë nuk ka kryer vepër tjetër penale, i gjendjes së mesme ekonomike, dhe kërkon falje të dëmtuarës, e cila prezantoi në seance, ndërsa si rrethanë rënduese nuk pati.

Sipas bindjes së lirë të kësaj gjykate caktimi i dënimit me kusht ndaj të akuzuarit Lulzim Ramadani, është marrë duke i pasur për bazë të gjitha rrethanat e lartcekura është dënim i të drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësorë është marrë në bazë të nenit 451 të KPRK-së

Duke u bazuar nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr.1300/16 më datë 18 prill 2017**

**Zyrtarja ligjore,**  
Florentina Ademi

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Ramiz Azizi

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.

